

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 22 SHTATOR 2022

Jo rastësisht për herë të parë unë prita i ulur në një karrige të deputetëve socialistë. E bëra këtë me qëllimin më të sigurtë: për t'u thënë socialistëve shqiptarë se sot avokatë të vetëm të tyre në këtë parlament janë demokratët dhe do të vazhdojmë deri në fund të jemi zëdhënës të interesave qytetare të shqiptarëve, pa dallim bindjesh politike. Në këtë mënyrë se si është katandisur ky parlament, sot më shumë se kurrë qytetarët shqiptarë kanë nevojë për përfaqësim në këtë aulë. Unë dëgjova këtu diskutime, por sot, të dashur qytetarë, është koha për veprime. Këta janë nga mëngjesi deri në darkë të angazhuar në dy aktivitete kryesore: në mashtrimin dhe në vjedhjen tuaj, por koha ka ardhur që ne kësaj qeverie t'i tregojmë vendin.

Jam këtu për t'u bërë thirrje të gjithë mësuesve të Shqipërisë, që me guxim dhe kurajë të mbrojnë interesat e tyre, të mbrohen nga nënçmimi, përçmimi që u bën ky regjim, kjo qeveri. Janë të vetmit mësues në rajon që në 8 vjet jo vetëm që nuk njohën rritje, por, krahasuar me inflacionin, patën një ulje të ndjeshme të rrogës. Janë njerëzit më të përçmuar në administratë, ndërkohë që ata duhet të jenë qytetarët dhe njerëzit më të nderuar për misionin e tyre fisnik. Të nderuar mësuese dhe mësues, ju vetë e konstatoni se si po rrënohet sot sistemi arsimor, se çfarë sage vuajtjeje dhe mjerimi u krijon portali i kësaj zonjës, portali "Kushi", portali i partisë, portali i mashtrimit dhe i falsifikimit.

Se si një mësues qoftë edhe i ekselencës, për bindjet e tij duhet të presë 7-8 vjet pasi të ketë mbaruar çdo gjë për t'u sistemuar ose nuk sistemohet fare. U bëj thirrje sindikatave: shkëputuni nga plogështia juaj dhe të organizojmë grevën e përgjithshme, e cila është grevë për dinjitetin e secilit, në radhë të parë! U bëj thirrje mjekëve, bluzave të bardhëve, që shohin rrënimin e sistemit shëndetësor, që e shohin se si shqiptarët vdiqën nga pandemia, 250 për qind më shumë se mesatarja e BE-së; vdiqën më shumë se në çdo vend tjetër të Europës, vdiqën sa në 3-4 vende dhe patën vdekshmërinë më të lartë në botë nga Covid-i. Mjekë të shkëlqyer largohen nga vendi, infermierët ikin.

Të gjitha këto, sepse janë njerëzit më të keqpaguar, më të keqtrajtuar, më të keqvlërësuar. Atëherë, çfarë mbetet, të dashura kolege dhe kolegë, të dashur infermierë dhe infermiere?! Greva, greva dhe para së gjithash greva! I drejtohem këtu biznesit të vogël, që ka një armik të vërtetë në këtë qeveri e cila pret fundin dhe për dy muaj do t'u vendosë 23 përqindëshin, e cila rriti tarifën e energjisë në 200 lekë. Çfarë presin më?! Thirrja e çdo biznesmeni, e fëmijëve të tyre, e grave dhe miqve të tyre është: të ulen qepenat, grevë e përgjithshme, grevë e përgjithshme, grevë e përgjithshme... U bëj thirrje të gjithë studentëve (bashkëmoshatarëve të tyre në Kosovë qeveria u dha nga 100 euro, kurse kjo qeveri u jep mashtrimin, nënçmimin, përçmimin) të organizohen në një lëvizje të fuqishme studentore.

U garantoj se ne jemi 10-20-30 herë më të fuqishëm se këta që i vjedhin çdo ditë qytetarët shqiptarë. U bëj thirrje pedagogëve të universiteteve që të ngrihen fuqishëm. Të mos lënë një copë injorant t'u përmendë rrogën e dijen, një njeri që nuk është i denjë as për mësues vizatimi, por që mburret se s'ka master dhe s'ka doktoratë. U bëj thirrje të organizohen! I bëj thirrje sindikatës, sepse vetëm greva e përgjithshme është rruga për t'i prerë biletën aty ku e meriton kjo qeveri kampione në të zeza dhe vjedhje! U bëj thirrje policëve të shtetit, policëve të vërtetë, të cilëve nuk u paguhet asgjë nga djersa që derdhin, të cilët mashtrohen nga mëngjesi deri në darkë, të cilët trajtohen si qenie inferiore nga shefat e tyre.

E dëgjuat Panganikën çfarë i thoshte oficerit? Çfarë pësoi Paganika që i tha plehrë oficerit me uniformë? Asgjë nuk pësoi, sepse Paganika është mik i Veliajt dhe i Ramës, është një turp i dheut, është një turp i oficerit. Po atë marrëdhënie kanë ministrat me vartësit e tyre, i trajtojnë me mungesë dinjiteti, i terrorizojnë. U bëj thirrje të gjithë punonjësve të administratës të marrin pjesë në grevë dhe vetëm në grevë. Koha po thërret. Ora po vjen. Ne duhet të jemi në lartësi dhe jo të shohim dhe të vajtojmë. U bëj thirrje taksistëve dhe çdo qytetari që drejton makina, të mos pranojnë këtë tirani të çmimit të naftës, sepse ajo është vendosur nga qeveria dhe nga kontrabanda e saj.

U bëj thirrje qytetarëve, demokratë e socialistë dhe të çdo bindjeje, të ngrihen, sepse kjo që ndodh me çmimet, nuk ndodh në asnjë vend të botës, sepse bordet komuniste të Edi Ramës kanë rritur çmimet e kafshatës së bukës, të djathit, të qumështit, më shumë se në çdo vend

tjetër të Europës. U bëj thirrje nxënësve të gjimnazeve të ngrihen së bashku me studentët në protesta të përgjithshme dhe të shpëtojnë nga ky regjim i kalbur monist, personal i një njeriu. Koha nuk pret. Ndaj dhe ky parlament duhet t'i ketë kohërat e numëruara. Ky parlament ka marrë fund. Që kur ekzekutivi merr kompetencat e tij, parlamenti nuk ka pse ekziston më. Do të përballeni me qytetarët shqiptarë. Ky është zotimi solemn në emër të Partisë Demokratike dhe të opozitës.